



“Horizonti i Ri” organizoi seminarin për hartimin e Planit lokal për parandalimin e sëmundjeve të varësisë

Përfundim me sukses i projektit

Ky aktivitet njëherësh shënoi edhe fazën përfundimtare të projektit njëvjeçar “Partneriteti lokal në luftën kundër abuzimit me droga dhe delikuencës së të miturve”, i cili ka pasur për qëllim vendosjen e bashkëpunimit më efikas në çështjet e edukimit të fëmijëve dhe të rinjve, shkëmbimit të njohurive dhe përvojave pozitive në këtë fushë si dhe fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës për Parandalimin e Sëmundjeve të Varësisë të Komunës së Ulqinit

Ulqin - Organizata e Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri” organizoi javën që shkoi seminarin për hartimin e Planit lokal për parandalimin e sëmundjeve të varësisë. Ky aktivitet tuboi së bashku përfaqësuesit e të gjitha institucioneve relevante që veprojnë në nivel të Komunës së Ulqinit e të cilët njëkohësisht përbëjnë edhe Rrjetin e partnerëve lokalë për luftimin e abuzimit me droga dhe delikuencës së të miturve.

Seminarin e hapi kryetari i Komunës së Ulqinit, Nazif Cungu, i cili përgëzoi për punën e deritanishme të gjithë subjektet të përfshirë në këtë projekt dhe premtoi mbështetjen e fuqishme të pushtetit vendor për iniciativat dhe

projektet që kanë për qëllim krijimin e një ambienti të shëndetshëm dhe të sigurt për të rinjtë e Ulqinit.

Përveç funksionarëve dhe zyrtarëve të administratës së Komunës së Ulqinit, në hartimin e këtij dokumenti një kontribut të çmueshëm dhanë edhe drejtuesit e Prokurorisë Shtetërore në Ulqin dhe Zyrës së Policisë, përfaqësuesit e Gjykatës Themelore në Ulqin, Qendrës për Punë Sociale, Shtëpisë së Shëndetit, institucioneve arsimore, Televizionit “Teuta”, profesionistë të shoqërisë civile, edukatorët bashkëmohatarë në fushën e parandalimit të sëmundjeve të varësisë e tjerë.

Ky aktivitet njëherësh shënoi edhe

fazën përfundimtare të projektit njëvjeçar “Partneriteti lokal në luftën kundër abuzimit me droga dhe delikuencës së të miturve”, i cili ka pasur për qëllim vendosjen e bashkëpunimit më efikas në çështjet e edukimit të fëmijëve dhe të rinjve, shkëmbimit të njohurive dhe përvojave pozitive në këtë fushë si dhe fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës për Parandalimin e Sëmundjeve të Varësisë të Komunës së Ulqinit.

Këtë projekt “Horizonti i Ri” e realizoi me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Podgoricë, përmes Byrosë për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit.

(Kohapress)